



Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

KEC

Kodi: 040

Monitorimi i menaxhimit të financave komunale të arsimit

Qëllimet e Programit

Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit përfitojnë:

- Njohjen pasqyrat financiare të drejtorive komunale të arsimit
- Aftësimin për monitorimin e pasqyrave financiare të drejtorive komunale të arsimit dhe shkollave sipas “Kornizës së monitorimit”.

Përmbajtja e trajnimit

Trajnimi përmban tri module.

- Korrupsioni – kuptimi, format e manifestimit dhe strategjitë për luftimin e tij.
- Financat qendrore dhe lokale – grumbullimi dhe shpenzimi me theks të veçantë në financat në arsim.
- Korniza e monitorimit – aspekte praktike të monitorimit.

Dy modulet e para janë të fokusuar në prezantimin e koncepteve themelore që janë të nevojshme të njihen për të realizuar një monitorim të suksesshëm të financave komunale të arsimit, ndërsa moduli i tretë sqaron mënyrën praktike të realizimit të monitorimit. Në kuadër të modulit të tretë prezantohen fushat e monitorimit dhe treguesit, organizimi i monitorimit dhe instrumentet për monitorim.

Grupi i synuar

Ky program u dedikohet personave që kanë përvojë në monitorim dhe në menaxhim financiar.

Forma e organizimit/Kohëzgjatja

Trajnimi organizohet në formë të tri seminareve 2-ditore, të cilat zhvillohen gjatë një muaji. Programi ka gjithsej 45 orë.

Certifikimi

Kusht për certifikim është pjesëmarrja 90% në trajnim.